TË DHËNAT TEKNIKE

ZEUS-AL

Bojra & Verniqe

GRAFIATO

VESHJE DEKORATIVE
E GATSHME PËR PËRDORIM

PËRSHKRIMI TEKNIK

GRAFIATO është një veshje decorative e gatshme për përdorim e cila bazohet në emulsione (rezina) speciale të tipit kopolimer.Shërben për trajtimin e fasadave dhe sipërfaqeve të jashtme dhe të brendshme.
Është produkt me performancë të lartë dhe karakterizohet nga një mbulueshmëri shumë e mirë,është rezistent ndaj larjes, gërvishtjeve, dhe kushteve atmosferike.
Produkti nuk përbën rrezik për përdoruesin apo mjedisin. Duke qenë se ka nivel të ulët arome, është e përshtatshme për përdorim të brendshëm edhe të jashtëm.
Nuk ka përmbajtje metali të rëndë.

CILËSITË

Aplikohet lehtë duke krijuar një strukturë të bukur, të qëndrueshme dhe rezistente ndaj kushteve atmosferike. Lejon përshkueshmërinë e strukturës ndaj avujve. Bardhësi perfekte, rezistente ndaj rrezeve UV dhe gërvishtjeve. E ruan ngjyrën të paprekur për një periudhë të gjatë kohore. Mund të lahet lehtë me ujë duke qenë se nuk dëmtohet nga detergjentët. Nuk mban erë dhe është rezistente ndaj zverdhjes.
Produkti mund të aplikohet shumë lehtë nëpërmjet një malle.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret për krijimin e veshjeve dekorative me cilësi mjaft të mira hidroizoluese të sipërfaqeve të brendshme ose të jashtme, të cilat janë me suva, allçi, stuko, beton, etj, veçanërisht në vendet ku duhet të kemi një nivel të ulët të aromës dhe emetimit të soventëve organik gjatë përdorimit.

VOC (Përbërësit e Paqëndrueshëm Organik)
Vlera limit e BE: për këtë kategori produkti A/a (Për muret e brendshme mat dhe tavanet) : 75g /l (2007) dhe 30g /l (2010).
Ky produkt përmban maksimalisht 5 g/l VOC.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. “Asti Gogoli”, ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com

GRAFIATO

VESHJE DEKORATIVE
E GATSHME PËR PËRDORIM

APLIKIMI

Sipërfaqja ku do te aplikohet **GRAFIATO** duhet të nivelohet dhe pastrohet më parë nga pluhurat, vajrat, yndyrnat,etj.
Përdor SPECIAL STUCCO të **ZEUS-AL** për të mbushur dhe veshur sipërfaqet e dëmtuara.
Përpara aplikimit te **GRAFIATO**, sipërfaqet duhet të trajtohen me një dorë astar GRAFIATO PRIMER të holluar deri në masën 10% me ujë dhe pas tharjes të kalohet një dorë **GRAFIATO**.
Hollimi: I gatshëm për përdorim.
Mënyra e aplikimit: Aplikimi i produktit bëhet nëpërmjet një malle. Menjëherë pas aplikimit të produktit në sipërfaqe, bëhet rrafshimi i tij dhe punohet ne drejtimin horizontal,vertikal ose rrethor në varësi të efektit estetik që dëshirojmë të realizohet.
Temperatura e aplikimit: 5 deri në 35°C.

TË DHËNA TEKNIKE

Ngjyra: E bardhë & ngjyra
Rezina: Kopolimer
Densiteti (e bardhë): 1.50±0.01 gr/ml (EN ISO 2811.01-02, 20°C)
Viskoziteti i produktit: 103±5 KU (ASTM D 562-05, 25°C)
Viskoziteti i magazinimit: 110±10 KU (ASTM D 562-05, 25°C)
Substanca të ngurta sipas peshës (e bardhë): 87±2% (EN ISO 3251-03)
pH: 8.5-9.0 (ISO 976-96)
Temperatura minimale e formimit te filmit : 0°C (ASTM D 2354)
Qëndrueshmëria në paketim: 10/10 (1 muaj, 50°C) (ASTM D 1849-03)
Shkëlqimi, në 85°: 6±2 (ELOT EN ISO 2813-99)
Koha e tharjes në 25° C:

- Tharja në sipërfaqe: 20-40 min
- Tharja ne brëndësi: 45-60 orë

Pika e ndezjes: n.a. (ELOT EN ISO 1523-02)
Ngjitja ne çimento(ndër-prerë): 0 (ELOT EN ISO 2409-95)
Rendimenti:
Struktura 1.5 mm = 2.1 kg /m² Struktura 2.5 mm = 2.8 kg /m²
Struktura 2.0 mm = 2.5 kg /m² Struktura 3.0 mm = 3.2 kg /m²

Shënim:

- Rekomandohet që sipërfaqet e veshura me GRAFIATO të lahen 20-30 ditë pas aplikimit të saj, në rast se është e nevojshme.
- Mbi sipërfaqe me suvatim të freskët, rekomandohet që produkti të aplikohet të pakën 30-40 ditë më pas.
- Rekomandohet shmangia e përdorimit të produktit në temperatura nën 0°C ose pak para shiut.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com